



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV
TIRANE

NR. 8003/3396/1195 Akti
DT. 10.10.2014 regjistrimit

NR.1446 VENDIMI

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

Blerona Hasa-----Kryesuese;
Artur Malaj-----Anetar;
Fjoralba Prifti-----Anetare,

asistuar nga sekretare gjyqesore Fiorela Nukaj, sot me date 30.05.2016 ora 13.10, shqyrtoi ne dhome keshillimi, çeshtjen administrative Nr. 8003/3396/1195 Akti Dt.10.10.2014, me:

PADITESE: Shoqeria tregtare “Ndertuesi” shpk.

TE PADITUR: - Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.
- Drejtoria e Apelimit Tatimor.

OBJEKTI: Anullimi i aktit administrativ, njoftim vlerësimi Nr.10938 Dt.30.09.2012 dhe Vendimit Nr.21034/3 prot Dt.25.01.2013 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

BAZA LIGJORE: Nenet 324, 328 te K.Pr.Civile, Neni 106 e vijues te Ligjit Nr.9920/2008 “Per Procedurat tatimore”, Udhezimi Nr.24 Dt.02.09.2008 “Per procedurat tatimore”.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, me vendimin Nr.942, datë 16.04.2013, ka vendosur:

“- Pranimin e pjesshem te kerkese-padise se ngritur nga paditesi.

- Anullimin e aktit administrativ. Njoftim Vlerësimi Tatimore me nr.10938 date 03.09.2012 ne lidhje me Proces-verbulin e gjohes me nr.seria 0163904 date 18.08.2012. gjohje shuma 200 000 (dyqind mije) leke i nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore, per mos leshim te kuponit tatimor.

- Anullimin e aktit administrativ nr.21034/3 prot date 25.01.2013, Vendimit i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve si nje akt i nxjerre ne kundërshtim me ligjin.

- Shpenzimet gjyqesore i lihen ne ngarkim pales se paditur.

VEREN

Se çështja po merret në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit mbi ankimin e palës së paditur DRT Vlorë, e cila kundërshton vendimin e gjykatës me të cilin është pranuar padia e paditëses Shoqërisë “Ndërtuesi” sh.p.k për anulimin e aktit të njoftimit të vlerësimit tatimor.

Nga aktet bashkëngjitur dosjes që i perket vendimit objekt ankimi rezulton se paditesi shoqëria tregtare “Ndertuesi” shpk, ushtron aktiviteti “Bar sezonal në Borsh”, Vlore, ambient, i cili ka qene i deklaruar prej kesaj shoqërie me adrese dytesore dhe i pajisur me kase fiskale.

Me date 18.02.2012 eshte ushtruar kontroll nga inspektoret tatimore te cilet kane kerkuar kopjen e fundit te kuponit tatimor qe kishte perdorur subjekti, e cila u eshte vene ne dizpozicion duke u printuar prej pajisjes fiskale dhe ata jane larguar pa kryer asnje veprim tjeter.

Pala paditese eshte njoftuar nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore qe i eshte vendosur nje gjobe ne shumen prej 200 000 leke, sipas procesverbalit te gjobes Nr.serie 0163904 Dt.18.08.2012 si dhe me Njoftimin e Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr.10 938 Dt.03.09.2012.

Pala paditese e ka ankimuar administrativisht këtë akt ne Drejtorine e Apelimit Tatimor, e cila me vendimin Nr.21034/3, Dt.25.01.2013, ka lene ne fuqi Njoftim Vleresimin Nr.10938 Dt.03.09.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore.

Duke mos qene dakord me sa me siper, paditesi shoqëria tregtare “Ndertuesi” shpk, ka bere çështjen konflikt gjyqësor, duke kerkuar nepermjet kerkespades se saj, anulimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi Nr.10938 Dt.30.09.2012 dhe te vendimit Nr.21034/3 prot Dt.25.01.2013 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, paditesi ka pretenduar se:

“ Shoqëria “NDERTUESI” SHPK eshte nje paguese e rregullt e taksave dhe tatimeve prej krijimit te saj 1994.

Me date 18.08.2012 strukturat e administrates tatimore jane paraqitur ne ambientet e nje lokali veror, i cili administrohej prej shoqërise sone ne fshatin Borsh ne te cilin ushtrohej veprimtaria. Ky ambient eshte i deklaruar prej shoqërise sone si adrese dytesore per ushtrimin e aktivitetit Eshte pajisur me kasen fiskale konform ligjit. Grupi i kontrollit gjate ushtrimit te detyres se tij ka kërkuar ne rruge verbale te dhena si: Emrat e punonjësve, Certifikaten e regjistrimit ne organet tatimore, pajisjen me kase fiskale, e cila u verifikua edhe duke u pare vizualisht.

Gjate kohes se ushtrimit te kontrollit ne lokal nuk ndodhej asnje klient pra lokali ishte bosh. Prej kontrollit u kerkuar kopja e kuponit te fundit te prere e cila u vu ne dispozicion duke u printuar rregullisht prej paisjes fiskale. Kjo kopje u terhoq prej grupit te kontrollit, i cili u largua pa lene asnje dokument te shkruar apo dyshim per parregullsi pasi vet dokumentacioni dhe rrethanat nuk linin hapsire te tille.

Me pas jemi njoftuar per P.v. e gjobes seria 0163904 date 18.08.2012, gjobe shuma 200 000 leke.

- a) kur aktet administrative komunikohen gojarisht ne prani te paleve te interesuara;
- b) kur pala e interesuar, merr pjese ne zhvillimin e procedimit administrativ dhe manifeston njohuri te plota ne lidhje me aktin administrativ ne fjale.

Ne rastin te cilin po parashtrojme akti i procedimit administrativ procesverbal gjobe i cili mban daten 18.08.2012 nuk eshte i shoqeruar me akt-konstatimin perkates i detyrueshem sipas dispozitave tatimore per pershkrimin e rrethanave te ngjarjes te veprimit apo mosveprimit prej ne raportin dypalesh subjekt shites- klient ne rastin tone.

Ky akt-konstatimi eshte i kerkuar drejtorise se apelit tatimor gjate shqyrtimit administrativ por nje i tille sikunder ju vertetojme me shkresat e kerkeses dhe pergjigjes ndaj DRT-Vlore nuk ekziston.

Pra ne rastin tone mungon pershkrimi i rrethanave te ngjarjes, i cili perben dhe arsyetimin e qarte dhe te sakte te fakteve te ndodhura. Ne rastin tone ne aktin administrativ nuk pershkruhet apo disponohet nje fakt i cili te vertetoje se ne momentin e kontrollit nuk leshohet kupon tatimor.

Inspektoret hartues te aktit administrativ jane mjaftuar vetem me nje procesverbal gjobe te mbajtur ne mungese dhe nuk kane pasqyruar asnje te dhene ne lidhje me thelbin e procedimit administrativ si psh

- Sa tavolina jane gjithesej ne lokal dhe sa prej tyre jane te zena.. ?

Sa kliente ka ne tavolinen e sherbyer.. ?

Cfare malli i eshte sherbyer klientit...?

Cfare vlere ka malli i sherbyer per te cilen duhet leshuar kuponi...?ETJ...

Keto apo te ngjashme me to jane disa prej rrethanave te cilat duhet te pershkruheshin ne aktin e konstatimit por akti administrativ i permbledhur ne procesverbal gjobe percakton me dy Pale te pergjithshme **subjekti nuk leshonte kupon tatimor**. Arsyetimi mungon ne teresi per sa i perket:

1. Qartesis se rrethanave te ngjarjes
2. Shpjegimeve te fakteve

Sipas nenit 108 te Kodit te procedures administrative percaktohet se:

VLEFSHMERIA E AKTEVE ADMINISTRATIVE

Arsyetimi i aktit

1. Pervec rasteve kur ligji vete parashikon dhenien e arsyeve, duhet te jepen domosdoshmerisht arsytet per te gjitha ato akte te cilat pjeserisht ose teresisht: a) mohojne, shuajne, kufizojne apo prekin ne ndonje menyre tjeter te drejta dhe interesa te ligjshem ose vendosin apo rendojne detyrime apo ndeshkime;

Neni 109 Menytrat e arsyetimit:

1. Arsyetimi duhet te jete i qarte dhe te perfshije shpjegimin e bazes ligjore dhe faktike te aktit.
2. Perdorimi per arsyetim i te dhenave te paqarta, kontradiktore ose te pasakta eshte i barazvlefshem me mungesen e arsyetimit.

Ne zbatim te nenit 109 te Kodit te Procedurave Administrative arsyetimi ne akt eshte i pavlefshem per krijimin e pasojave ndeshkuese per subjektin tone dhe per kete ju kerkojme anulimin e tij.

Akti administrativ i mbajtur prej inspektoreve tatimorë eshte shqyrtuar prej Drejtorise se Apelit Tatimor, e cila gjate zhvillimit te procedures se shqyrtimit administrativ ne perputhje me piken 108.2.1 te Udhhezimit Nr.24 te Ministris te Financave Per Procedurat Tatimore (i ndryshuar) ka

108.3.3 Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor duhet te nenshkruhet dhe vuloset nga Drejtori i Drejtorise se Apelimit Tatimor ose personi i autorizuar prej tij. Vendimi duhet te perfshije nje shpjegim me shkrim te bazes se tij, duke perfshire menyren e arsytimit si parashikohet ne nenin 108 te Ligjit te Procedurave Administrative. Per te gjithë pjesemarrësit ne proceduren e ankimit duhet te jete e qarte pse Drejtoria e Apelimit Tatimor ka marre nje vendim tecaktuar. Arsyetimi duhet te jete:

a) I qarte dhe te perfshije shpjegimin e bazes ligjore dhe faktike te aktit.

b) Perdorimi per arsyetim i te dhenave te paqarta, kontradiktore ose te pasakta eshte i barasvlershem me mungesen e arsytimit".

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, i padituri Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore, ka prapsuar te njejtat fakte, te konfirmuara edhe ne ankimin respektiv kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare, pasqyruar ne pjesen hyrese te vendimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, me Vendimin Nr. 942 Dt.16.04.2013, ka vendosur pranimin e pjesshem te kerkespadise, sipas disponimeve te pasqyruara ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke argumentuar se:

Padia e ngritur nga paditesi eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova ne lidhje me Njoftim Vleresim per detyrimet me Njoftim Vleresimit Nr.10938 date 03.09.2012 (gjobe), e nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore, i nxjerre ne mbeshtetje te proces-verbalit te gjobes me nr. serie 0163904, date 18.08.2012 per shumen 200.000 (dyqindmije) leke per mos leshim te kuponit tatimor subjekti tatimor "Ndertuesi" sh.p.k Vlore pasi ky akt është nje akt administrative i nxjerre ne kundërshtim me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji.

Akti që kundërshtohet është nxjerre ne kundërshtim me ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH". i ndryshuar dhe VKM-të perkatese dale ne zbatim te ketij ligji.

Në secancë gjyqesore është pranuar se inspektorët e tatimeve kane shkuar ne lokalin tip bar ne Borsh dhe kane gjetur vetem punonjesin qe sherbente ne kete lokal.

Kane kerkuar kuponin e fundit tatimor dhe kane marre kopjen e kuponit te fundit tatimor nr.2

Nuk rezulton qe punonjesit e tatimeve te kene mbajtur ndonje akt-konstatimi ne lokal.

Ky fakt eshte konstatuar edhe nga vete pala e paditur Drejtoria e Apelimit tatimor Tirane, e cila me shkresen nr.21034/1 Prot,date 01.10.2012 i ka kerkuar pales paditese plotësimin e dokumentacionit me paraqitjen e akt- konstatimit me te cilin të pershkruhet gjendja e konstatuar.

Me shkresen nr.12519/1 Prot, date 09.10.2012 i eshte kthyer pergjigje subjektit ankues (padites) se akt konstatimi nuk ka ardhur me shkrese përcjellese nga DPT Tirane.

Megjithese pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane eshte vene ne dijeni te faktit te mungeses se aktit te konstatimit ka marre ne shqyrtim ankimin e pales paditese dhe perfundimisht ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrative objekt ankimi "Njoftim vleresimi me nr.10938,Prot,date 30.09.2012" të Drejtorise rajonale tatimore Vlore per shumen 200.000 (dyqind mije) leke per mosleshim kuponi.

Proces-verbali i gjobes del mbasi eshte kryer akti i konstatimit. Per derisa nuk kemi konstatim te gjendjes, faktit ku te pasqyrohen ne te shkeljet e konstatuara.

Në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se organet e tatimore siç janë inspektorët e DRT Vlorë kanë të drejtë që të vendosin gjoba në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve dhe më pas DRT ka të drejtë që të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore sipas nenit 70 të ligjit 9920/2008.

Sipas nenit 122.1.b.i me titull “Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave” të ligjit 9920/2008 përcaktohet se:

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin.

Sipas pikës 122.5 të UMF nr. 24/2008 përcaktohet se :

Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këtë nen (neni 122 i ligjit 9920/2008) bëhen nga organet tatimore të juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet. Në rastet kur strukturat qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve disponojnë informacione ose ndërmarrin verifikime ne terren,verifikime dhe kontrole të tilla duhet të ushtrohen në bashkëpunim me strukturat përkatëse të organeve tatimore të juridiksionit.

Sipas nenit 13.1. a.b.c të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” përcaktohet se : Për kundërvajtjen administrative parashikohet:

a) marrja e gjobës në vend. në rastet kur kjo parashikohet nga ligji i veçantë;

b) mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve te pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja;

c) nxjerrja dhe njoftimi i vendimit të organit të ngarkuar nga ligji, kur konstatimi i ngjarjes lidhet me shqyrtimin e dokumentacionit apo të të dhënave të tjera.

Neni 14

Mënyra e mbajtjes së procesverbalit apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të

1. Procesverbali i përmendur në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtësit dhe të dëshmitarëve të pramishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pramishëm, në rast se ka. Në procesverbal shënohen identiteti i kundërvajtësit dhe lloji i kundërvajtjes.

kundërvajtjes administrative, qoftë me një akt-konstatimi të përpiluar veçmas, qoftë në procesverbalin e gjobës të përpiluar në vend.

Në rastin e dënimeve për kundërvajtje administrative barrën e provës për të provuar ekzistencën e kundërvajtjes e ka organi që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative e nuk mund t'i kërkohet kundërvajtësit të provojë të kundërtën. (neni 26.3 i ligjit për kundërvajtjet).

Barra e provës kalon tek kundërvajtësi, në rastet kur organi që ka konstatuar kundërvajtjen e ka kryer konstatimin sipas ligjit, por kundërvajtësi arrin të provojë se konstatimi ishte i gabuar , nuk i përgjigjej situatës faktike, apo se ai nuk kishte faj për kryerjen e kundërvajtjes.

Ky konkluzion arrihet edhe nga përcaktimi i nenit 4 të ligjit 10 279/2010 “ Për Kundërvajtjet administrative”, sipas të cilit përcaktohet se kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrative.

Gjykata Administrative e Apelit referuar procesverbalit të gjobës të datës 18. 08.2012, i mbajtur në ambientet ku ushtronte veprimtarinë pala paditëse dhe rrethanave të përshkuara në të, arrin në konkluzionin se pavarësisht se ai është mbajtur sipas kërkesave formale të përcaktuar në nenet 13.1 , 13.2 dhe 14 të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në përmbytjen e tij nuk pasqyrohet konstatimi i shkeljes që përbën kundërvajtje për të provuar se pala paditëse ka kryer kundërvajtjen administrative dhe për pasojë pala e paditur ka proceduar me dënimin me gjobë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 4 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 dhe nenit 122.1.b.i të ligjit 9920/2008 dhe pikës 122.5 të UMF nr. 24/2008 .

Në këto rrethana, Gjykata Gjykata Administrative e Apelit arrin në konkluzionin se me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka proceduar me anulimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor me nr.10938 date 03.09.2012 të Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Vlore dhe aktit administrativ nr.21034/3 prot, datë 25.01.2013 të Drejtorisë se Apelimit Tatimor Tirane prane Drejtorisë se Pergjithshme te Tatimeve , akte këto të nxjerra mbi bazën e Proces-verbali të gjobes me nr.serie 0163904 date 18.08.2012, si akte të pavlefshme për shkak se janë nxjerrë në kundërshtim me dispozit ligjore të përshkuara më sipër.

Për të gjitha sa u parashtuan më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma “b” të ligjit Nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vlerëson se vendimi nr. 942, datë 16.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë duhet të lihet në fuqi, si një vendim i drejtë, i mbështetur në prova dhe në ligj.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekur në gjykatën e Lartë pasi sipas nenit 56.a të ligjit 49/2012 përcaktohet se: Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

• • PËR KËTO ARSYE • •

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "b" dhe 56.a të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 942, datë 16.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Shpenzime gjyqësore nuk u kryen.
- Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall, sot në Tiranë, më datë 30.05.2016.

ANËTARE

FJORALBA PRIFTI

dv

ANËTAR

ARTUR MALAJ

dv

KRYESUESE

BLERONA HASA

(Kundër)

dv

E NJEHSUAR ME ORIGJINALIN